REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
R E K T O R A T I

Nr. 1818 Prot Gjirokastër, më 23 .10. 2026

MIRATOI
REKTORI
Prof. dr. Jaho CANA

Lënda: Hapet Thirrja Publike për Projekt-Propozime për Grupet Joformale Rinore për vitin 2026 nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka hapur Thirrjen Publike për Projekt-Propozime për Grupet Joformale Rinore për vitin 2026, me synim mbështetjen financiare të nismave komunitare të ideuara dhe zbatuara nga të rinjtë, fuqizimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në komunitet dhe adresimin e nevojave dhe problematikave rinore në nivel vendor, në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029 dhe kriteret e përcaktuara në udhëzuesin e thirrjes, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Thirrja e Parë për Projekt-Propozime – Grupet Joformale Rinore	**09.11.2026**

1. Hapet Thirrja Publike për Projekt-Propozime për Grupet Joformale Rinore për vitin 2026 nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

Thirrja Publike për Projekt-Propozime për Grupet Joformale Rinore, e hapur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), synon të mbështesë nismat komunitare të ideuara dhe të zbatuara nga vetë të rinjtë, duke krijuar mundësi për pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën komunitare, zhvillimin e aftësive dhe adresimin e problematikave rinore në nivel vendor.

Qëllimi i thirrjes

1. Programi synon të fuqizojë grupet joformale rinore nëpërmjet mbështetjes financiare për iniciativa jofitimprurëse me ndikim konkret në komunitet, duke nxitur aktivizmin qytetar, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e të rinjve.

2. Objektivat e thirrjes janë:

Programi synon:
a) Rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën komunitare dhe në vendimmarrjen vendore;
b) Mbështetja e nismave rinore që adresojnë nevojat dhe problematikat e komuniteteve lokale;
c) Zhvillimi i aftësive, novacionit, orientimit profesional dhe mundësive për punësim të të rinjve;
d) Nxitja e vullnetarizmit, aktivizmit qytetar dhe lidershipit rinor;
e) Promovimi i mirëqenies fizike dhe mendore, sigurisë dhe gjithëpërfshirjes sociale;
f) Mbështetja e iniciativave që promovojnë artin, kulturën, sportin dhe mbrojtjen e mjedisit;
g) Fuqizimi i grupeve joformale rinore si aktorë të zhvillimit të komunitetit vendor;
h) Promovimi i barazisë gjinore, mosdiskriminimit, përfshirjes sociale dhe vlerave demokratike.

Fushat Prioritare

Projekt-propozimet duhet të adresojnë të paktën njërin nga tre qëllimet politike të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, si më poshtë:

- **Pjesëmarrja aktive dhe fuqizimi qytetar** – nisma për vullnetarizmin, edukimin qytetar, aktivizmin rinor, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe përmirësimin e jetës komunitare.
- **Novacioni, aftësimi dhe punësimi** – projekte që zhvillojnë aftësitë profesionale dhe digjitale, sipërmarrjen rinore, orientimin në karrierë dhe edukimin joformal.
- **Mirëqenia, siguria dhe gjithëpërfshirja** – iniciativa që promovojnë shëndetin mendor dhe fizik, artin, kulturën, sportin, mbrojtjen e mjedisit dhe përfshirjen e të rinjve nga grupet vulnerabël.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR): (https://rinia.gov.al/thirrja-e-pare-per-projekt-propozime-grupet-joformale-rinore/)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhenieve me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Marrëdheniet me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj